



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/02-1348

Dt: 30.01.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me formimin e komisionit vlerësues për organizimin e aktivitetit sportiv “Laureati i Vitit 2023”, për të gjitha kategoritë e sportit në Komunën e Gjakovës, me datë 30.01.2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për organizimin e aktivitetit sportiv “Laureati i Vitit 2023”, për të gjitha kategoritë e sportit, në këtë përbërje:
 1. Faruk Domi - kryesues i komisionit
 2. Labinot Efendiu - anëtar
 3. Drenusha Hoxha - anëtare
 4. Diana Mulaj - anëtare
 5. Leonard Cula - anëtar
2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, duhet të ndërmer veprime konform dispozitave ligjore në fuqi, propozimet e klubeve dhe në bazë të arritjeve dhe sukseseve të arritura në garat vendore dhe ndërkombëtare, bëjnë përzgjedhjen e laureatit më të dalluar për vitin 2023, në të gjitha kategoritë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Të gjithë anëtarëve të komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

